



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS



VENDIM

“Mbi vlerësimin e dëmeve nga ana ndërtimore të familjes së **Z.Sokol Prendush Gjeka**, banor i fshatit Hoten, Njësia Administrative Bushat”

Nr. 57 , datë 22 .11.2016

Bashkia Vau i Dejës pas ri-shqyrtimit të proces verbalit Nr.83/1, datë 14.07.2016 “Për konstatim të djegies se shtepise” të Komisionit të Verifikimit të Dëmeve (bashkëlidhur), Preventivin dhe “Vlerësimi i orendive, mobiljeve dhe pajisjeve elektroshtepiake ” të Komisionit të ekspertëve të Këshillit të Qarkut Shkodër (bashkëlidhur).

**Bazueshmëria ligjore:** ligji Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”; ligji Nr.8756 datë 26.03.2001 “Për emergjenat civile” i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave Nr.263 datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”; Udhëzimit Nr.4 datë 30.09.2015 i KM “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2015, Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës për të përballuar dëmet e shkaktuara nga djegia e banese se **Z. Sokol Prendush Gjoka** e përbërë nga 5 anëtarë, nga fshati Hoten, e ndodhur në datën 08.07.2016, Këshillit të Bashkisë me shumicë të cilësuar votash, ne mbledhjen e datës 22.11.2016:

VENDOSI:

1. Vlera e dëmit nga ana ndërtimore në shumën **11100** (njembedhete mije e njeqind ) leke dhe Vlerësimin e orendive, mobiljeve dhe pajisjeve elektroshtepiake ne vleren **304.560** (treqind e kater mije e peseqind e gjashtedhete) lekë, për familjen e **Z.Sokol Prendush Gjeka** sipas preventivit të hartuar nga Ekspertet e Këshillit të Qarkut Shkodër ne preventivin “Vlerësimi i orendive, mobiljeve dhe pajisjeve elektroshtepiake ”
2. Ti popozojë Ministrisë së Punëve të Brendshme dhënien e diferencës midis ndihmës financiare të dhënë nga Këshilli i Bashkisë Vau i Dejës me vendimin nr.39, datë 22.07.2016 në vlerën 10.000 lekë (bashkëngjitur) dhe dëmeve të konstatuara nga ana ndërtimore dhe ne orjendi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Emergjencave Civile.
4. Ky vendim hyn ne fuqi sipas parashikimeve të nenit 55 pika 6 e Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetqeverisjen vendore”.
6. U shpall sot me datë 25 .11.2016

SEKRETARI I KËSHILLIT  
Gentian NDOJ



KRYETARI I KËSHILLIT  
Martin MARKU